



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 16.06.2025

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 400/01-10196/25  
16.06.2025

**PROCESVERBAL**  
**Dragash - Dragaš**

**Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ,**  
**biznese dhe fermerë për**  
**Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028**  
**I mbajtur më 10.06.2025 (e martë)**  
**VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 27.05.2024.

**Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:**

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendari-Scan.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendar-boshnjakisht-Scan.pdf>

**Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1AdetTgAe/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/16jW695A3/>

**Njoftimi në uebfaqen zyrtare:**

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:00 dhe ka përfunduar në ora 12:00.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë 33 pjesëmarrës, prej tyre 31 meshkuj dhe 2 femra.

Kryetari i Komunës së Dragashit, z.Bexhet Xheladini, e bëri hapjen e këtij takimi dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë dëgjim buxhetor.

**Bexhet Xheladini:** Ju të gjithë që keni ardhur këtu e dini se çka do të thotë Buxheti. Buxheti nuk është pronë as e kryetarit, as e Qeverisë Komunale, as i Administratës. Buxheti është mjet me të cilin realizohen shumë kërkesa të qytetarëve. Komuna vetën e bën menaxhimin e këtij Buxheti në bazë të kërkesave të qytetarëve. Ne para më pak se dy javëve kemi pranuar projeksionin e buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028. Kësaj radhe, Buxheti i Komunës sonë është diku 13,254,881 euro. Me Buxhetin që e kemi, objektivi ynë është përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, zhvillimi ekonomik, ngritja e nivelit të shërbimeve në shëndetësi, në arsim, përmirësimi i infrastrukturës, ngritja e përkrahjes në sferën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke përfshirë këtu edhe përkrahjen e OJQ-ve dhe shoqatave, pastaj mbrojtja e ambientit, përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme, duke përfshirë përkrahjen e fermerëve, si dhe avancimi i barazisë gjinore dhe përkrahja e kërkesave të grave të Komunës sonë. Nga shuma totale e Buxhetit, Granti për Arsim është 4,741,000 euro; Granti për Shëndetësi është 1,661,000 euro; Investimet Kapitale janë 4,000,000 euro; Shpenzimet Komunale 400,000 euro; Subvencionet janë 400,000 euro. 52% e Buxhetit shkon për paga; 12% shkon për Mallra dhe Shërbime; 3% është për Shpenzime Komunale; 3% është për Subvencione; dhe 30% është për Investime Kapitale. Për fillim nuk dua ta zgjas më shumë, ia kisha kalue fjalën drejtorit të Financave.

**Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Ju përshëndes të gjithë ju të pranishmëve! Megjithëse në përgjithësi, në shtylla ta trasha, i tha pothuajse të gjitha kryetari, mu më duhet të ju njoftoj diçka. Ju e dini se këtë vit fillimisht Qarkorja e Parë Buxhetore na ka ardhë pa miratimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës. Shpresojmë se Qarkorja e Dytë Buxhetore e cila do të na vijë, do të kemi edhe një rritje tjetër buxhetore, për faktin se nuk janë konsoliduar ende institucionet e Qeverisë së Kosovës. Prandaj, ne ju kemi ftuar që, në bazë të KAB-it fillimisht të marrim kërkesat dhe prioritetet tuaja për investimet kapitale, para se me bo dëgjime buxhetore nëpër fshatra me qytetarët dhe grupet e interesit. Është me rëndësi të përmendet se edhe këtë vit, në raport me vitin tjetër, kemi një 3% të rritjes buxhetore, që i bjer diku 382,6667 euro më shumë se vitin e kaluar. Të gjitha këto mjete janë të parapara që t'i ndajmë në këto programe kryesore: Paga; Mallra dhe Shërbime; Shpenzime Komunale; Subvencione; dhe Investime Kapitale. Në qoftë se bëjmë krahasimin në raport me vitet tjera, ju e shihni se gjithashtu viteve të fundit kanë filluar të rriten mallrat dhe shërbimet, gjithashtu edhe shpenzimet komunale, por njëkohësisht edhe subvencionet. Në anën tjetër, të gjitha investimet kapitale që janë kryer në infrastrukturë gjatë këtyre viteve, kanë krijuar edhe shpenzime shtesë. Ju e dini se nëpër fshatra kemi filluar që t'i marrim përsipër edhe

shpenzimet e ndriçimit publik. Prandaj, nga buxheti i cili është paraparë për investime kapitale, do të ishte mirë që bashkërisht t'u japim një prioritet kërkesave të cilat janë më emergjente. Si prioritet kemi bujqësinë dhe turizmin. Projektet turistike kërkojnë një qasje ndryshe dhe ne shpresojmë që këtyre viteve të fokusohemi në këtë drejtim, i cili do të ndikojë në hapjen e vendeve të reja të punës. Prandaj kemi ftuar edhe bizneset private dhe përfaqësuesit të fshatrave, që të japin idetë e tyre, që bashkërisht të gjejmë një model të përbashkët për zhvillimin e ekonomisë në këto katër vitet e ardhshme.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, drejtor! Për fillim dua të ju them se ne, së pari, si prioritet do ta kemi pagesën e borxheve dhe obligimeve që dalin nga Kontrata kolektive dhe obligime të tjera, dhe pastaj pjesën tjetër do t'i marrim parasysh propozimet për investime kapitale gjatë tri viteve të ardhshme. Ne jemi duke zhvilluar këtë vit shumë projekte kapitale, shumica prej tyre janë dyvjeçare, projekte të cilat do të kryhen me buxhetin e këtij viti edhe me buxhetin e vitit të ardhshëm. Mirëpo, është me rëndësi që ne t'i marrim propozimet prej jush dhe, gjatë periudhës trevjeçare të planifikimit të buxhetit, ne këto projekte të juaj do t'i parashohim dhe do t'i qesim në dokumentacion dhe t'i miratojmë në Asambleenë Komunale. Atëherë, fjala është për ju!

**Uzair Hamza:** Përshëndetje të gjithëve. Fjalimi im i drejtohet më shumë përfaqësuesve nga komunitetet jo-shumicë. I ftoj përfaqësuesit e fshatrave të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre për investime kapitale. Zyra për komunitetet merr kërkesat nga përfaqësuesit e fshatrave dhe më pas i përpunon më tej këto kërkesa. Gjithashtu, dua të bëj apel që përfaqësuesit të kenë kujdes për personat me nevoja të veçanta. Ka raste kur përfaqësuesit nuk marrin parasysh nevojat e këtyre personave dhe, për shembull, shmangin të rregullojnë rrugët që përdoren nga ata. Më pas familjet e tyre individualisht vijnë tek ne dhe kërkojnë ndihmë. Pra, është shumë e rëndësishme që para kësaj të mbahen takime në fshatra dhe të përcaktohen prioritetet. Faleminderit!

**Kamber Kamberi, përfaqësues i fshatit Rapçë:** Përshëndetje të gjithëve. Unë jam përfaqësues i fshatit Rapçë. Problemi ynë kryesor në Rapçë është uji. Ne e dimë që projekti i ujësjellësit kryesor është në proces, dhe na intereson kur do të jetë ky ujësjellës në funksion? Pyetja tjetër gjithashtu lidhet me ujin në Rapçën e Poshtme, ku janë bërë 5 puse, dhe nga ato në tre janë vendosur pompa. Komuna ka investuar rreth 50 mijë euro, dhe besojë që ka mbetur vetëm disa punime të vogla për rezervuarët dhe të lidhë energjinë elektrike që sistemi të funksionojë. Pra, kemi dy projekte që lidhen me ujin. Problemi tjetër është qendra e mjekësisë familjare në fshat, ku ne kërkojmë që të kemi doktor dhe teknik gjatë javës, pra pesë ditë të punës gjatë javës. Duke pasur parasysh që kemi një popullsi të moshuar, nuk do të ishte keq të kishim edhe një ambulancë, nëse buxheti e lejon. Gjithashtu, mirë është që gjatë periudhës së verës të bëhet mirëmbajtja e rrugëve lokale. Komuna ka bërë një gjë shumë të mirë duke marrë përsipër mirëmbajtjen e ndriçimit publik, por kompania që e mirëmban,

ndonjëherë për shkak të një llambë, duhet të presësh 2-3 muaj që ta zëvendësojë dhe ne shpeshherë jemi të detyruar të shpenzojmë nga xhepi ynë për ta zëvendësuar vetë.

**Sehat Ibraimi, përfaqësues nga Dragashi:** Përsëritet të gjithë të pranishmëve, unë jam përfaqësues i Dragashit të Poshtëm. Mendoj se në kohët e fundit është punuar shumë, por disa projekte në Dragashin e Poshtëm nuk janë përfunduar plotësisht. Kubëzimi i rrugëve është bërë në masë të madhe, por nuk është përfunduar tërësisht. I ftoj institucionet që të dalin në terren bashkë me ne qytetarët dhe të mundohemi ta përfundojmë këtë punë. Unë kam dorëzuar kërkesë për ndërtimin e një muri mbrojtës në varrezat e qytetit, sepse ka erozion të tokës në atë zonë dhe ekziston rreziku i dëmtimit të varrezave. Po ashtu, do doja të kërkoja që të përfshihet edhe rruga nga ana e poshtme e varrezave, e cila më parë ishte në funksion. Problemi i dytë është ndriçimi, ku ne jemi pa ndriçim pothuajse një vit e gjysmë. Arsyet janë banale: njëra palë thotë se nuk janë përgjegjës, projekti nuk ka kaluar, ose investitori nuk ka ardhur, ndërsa ne kemi shumë të moshuar që jetojnë në periferi. Pika e tretë, unë do t'i propozoja drejtorit të financave, në interes të përmirësimit të jetës në këtë zonë, që të mendohet për një vend në Dragash, nga fabrika deri te stacioni i vjetër veterinar. Aty është një fushë dhe në atë pjesë nuk ekziston rrugë. Ka shumë parcela ku njerëzit do të donin të ndërtonin, por nuk kanë rrugë. Propozimi im është të bëhet një rrugë si ajo në fshatin Brod, ku lumi është futur në tuba, dhe mbi lumë të bëhet rrugë, që njerëzit të kenë qasje në parcelat e tyre.

**Ylli Qafleshi:** Përsëritet për të gjithë! Sot po foli si përfaqësues i fshatit Bellobrad, pasi që kryetari i fshatit nuk është këtu. Kam qenë në koordinim me të. E kam bo njëfarë listë të projekteve që ne mendojmë që për 3-4 vitet e ardhshme, për fshatin Bellobrad, me i realizue. Pasi që jemi në procedurë të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit edhe të rezervarëve, ne si fshat mendojmë që, për me u zgjidhë problemi i ujit në fshatin Bellobrad një herë e përgjithmonë, duhet instalim i ri i rrjetit të ujësjellësit nëpër komplet fshatin e Bellobradit. Pastaj, kemi kërkesë prej qytetarëve hapjen e rrugës nga “Sharra” nëpër Fusha. Pastaj, hapja e rrugës në lagjen “Baxhaku” deri në “Mbi Zabel”; Ndërtimi i shtegut të ecjes te lumi i fshatit Bellobrad; Mbulimi i stadionit të shkollës (vetëm me çelik, konstruksion metalik, jo me mure); Kubëzime të nevojshme nëpër fshat dhe kanalizime (e kemi një lagje komplet pa kanalizim). Këto janë disa kërkesa për 3-4 vitet e ardhshme për fshatin Bellobrad. Ju faleminderit!

**Beqir Beqaj, drejtor i Radio Sharrit:** Përsëritet për të gjithë! Për ata që nuk më njohin, jam drejtor i Radio Sharrit, jam edhe anëtar i Shoqatës së Afaristëve “Sharri”. Ju e dini që kjo shoqatë organizon Panairin tradicional të produkteve vendore dhe artizanaleve. Kështu që, po ju përcjelli një konkluzion nga ai panair, që ka rezultuar se vërtet kjo Komunë mund të zhvillohet, ashtu siç tha edhe drejtori për Ekonomi, z.Kolloni, përmes bujqësisë dhe turizmit. Prandaj, një kërkesë të veçantë e kam që – ky mandat tashmë po skadon, por në mandatin tjetër të mendohet që të ketë drejtori të posaçme për

Turizëm dhe për Bujqësi. Meqenëse janë shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik, komuna të veprojnë pa këto drejtori – unë e di që ka sektor në kuadër të drejtorive tjera, por kjo nuk mjafton. Duhet të kemi drejtori të posaçme për Turizëm dhe për Bujqësi. Desha të ju falënderoj për punët e mira që keni bërë. Ndriçimi publik përfundimisht po tregon që ka qenë më se i nevojshëm. Kryetar, një kërkesë që vërtet duhet ta merrni shumë seriozisht – ne po hapim rrugë të reja, por rruga ekzistuese nga “Ura e Beqës” deri në Mejdan, urgjentisht, nëse jo ministria, sepse ende ekziston si trase e ministrisë, duhet ta bëjmë patjetër ne si Komunë, sepse ajo rrugë është shndërruar në një rrugë ku bëhet hedhja e mbeturinave, e kafshëve të ngordhura. Pikërisht në atë rrugë shumë familje, gra e fëmijë dalin për të shëtitur, për të marrë ajër të pastër, dhe aty hasin në të gjitha këto pislleqe. Këtë kërkesën e fundit uroj ta merrni shumë seriozisht. Faleminderit!

**Nesim Qafleshi, biznesi N.T. “Çlirimi” – Bellobrad:** Përsëritet për të gjithë! Kërkesa ime ka qenë: Vijnë zgjedhjet nacionale, premtohet këtu turizëm. Veç premtime kemi, realizime nuk kemi. Vijnë fushatat komunale, kemi premtime për turizëm, realizime nuk kemi. Ne kemi ngelë peng. Unë kam investuar në Brod që nuk e di sa vjet aty, vetëm flen paratë kot, nuk më lejohet të ndërtoj asnjë villë, e lëre më më tepër. Duash ta investosh një fabrikë të ujit, kur vjen uji prej Shqipërisë ose prej skajit të Kosovës, kur ne jemi këtu, shes ujë të huaj e nuk shes ujin tonë. Kështu që, kisha bo një kërkesë, me ma dhënë një përgjigje. A ka ymyt, a nuk ka? A vetëm të dalim jashtë vendit të investojmë diku tjetër, qoftë në Shqipëri apo diku tjetër të investojmë, se këtu turizmi flitet, a nuk realizohet. Faleminderit!

**Nazim Dauti, menaxher i “Ekoregjonit” në Dragash:** Përsëritet për të gjithë! Pyetjen e parë e kisha për ujësjellësin. Meqenëse nuk e di qysh është projekti, po dua të informohem për pjesën e epërme, prej atyre shpiave të naltshme të Pllajnikut e deri të varrezat e Libëvishtit. Janë krejt shpia që e marrin ujin secila me zorrë prej bazenit tash aktualisht ku është. Shpiat e Pllajnikut nalt nuk kanë furnizim. A do të rregullohet kjo në kuadër të këtij projektit, ose masnej duhet me u bo një projekt që me mund me i furnizue me ujë këtë pjesën prej shpiave atje naltë, e deri te varrezat. Ose është në kuadër të këtij projektit që është duke u zhvilluar? Sepse, shkojnë ndoshta 10 gypa teposhtë rrugës, derisa mundet një gyp me u bo edhe na secila shpi me u kyç te i njëjti gyp. Tjetra: Duke qenë se e përfaqësoj “Ekoregjonin”, unë e kisha pas një kërkesë. Puna e kontenierëve nëpër qytet, a ka ndonjë projekt që Komunë t’i përcaktoj vendet e kontenierëve, edhe t’i rregullojë vendet e tyre në mënyrë që të mos lejohen qytetarët të hedhin edhe mbeturinat e ngurta. Për fund, një investim që do shumë mjete është puna e deponisë. Unë mendoj se është koha që deponia të zgjerohet. Ka mundësi të deponia ku është, me u zgjerue, përndryshe, ndoshta edhe nja dy vjet do të na paraqitet problem për deponinë, kështu që kjo duhet të merret pak më seriozisht. Faleminderit!

**Gazemend Ramadani, asambleist dhe përfaqësues i fshatit Brrut:** Përshëndetje për të gjithë! Kërkesat tona si fshat janë për një rrugë prej “Kodrës së Likenit” deri te “Vorri i Madh”, të bëhet trasimi. Pastaj, një rrugë e kemi prej Mejdanit të Buzezit që del në Brrut, me e trasue atë. Dhe një mur mbrojtës na duhet te shkolla e re, sepse çdo vit po rrëshqet dheu atje. Faleminderit!

**Bekim Vehapi, përfaqësues i fshatit Shajne:** Përshëndetje për të gjithë! Ne para dy muajve e kemi pas mbledhjen në fshat, kemi pas edhe zgjedhje të reja dhe në atë mbledhje mua më kanë zgjedhë si kryetar të fshatit. Sot jam në cilësinë e kryetarit të fshatit Shajne. Me projektet jemi shumë pak të njoftuar. Unë kisha pas një pyetje. Po na intereson, a është planifikuar edhe fshati Shajne në këtë projektin dyvjeçar 2026-2027? Nëse po, a ka pru projekte dikush për t’i realizuar për këtë periudhë kohore, edhe a kanë mbet mjete që ne si Kryesi e re të bëjmë propozime dhe planifikime të reja për punime të reja në fshatin Shajne. Problemet të cilat momentalisht janë evidente në fshatin Shajne, e kemi problemin me ndriçim. Vijnë ekipi, bëjnë ndriçime të reja, instalojnë rrjet të ri, ndërsa dritat e vjetra ku ka qenë instalimi më herët, ndoshta 20 drita janë djegë edhe aty nuk ka ndriçim. Problemi tjetër është që tash do të na paraqitet. Ashtu siç e dimë, më 20 korrik bëhet rruga njëkahëshe. Prej urës e deri te kthesa ku po ndahet rruga njëkahëshe, aty ka fjet ajo rrugë, Renelual Tahiri pas disa viteve e ka shtri kabllon. Edhe pse kanë premtime se kanë me e rregullue. Ajo do të bëjë pengesë shumë, jo vetëm për qytetarët e Shajnes, por për të gjithë ata që e shfrytëzojnë atë rrugë. Mirë është, nëse ka mundësi, para sezonit me intervenue, me i hek ato kubëzat, me e rrafshue vendit edhe me e kthye prapë në vend, që të jetë e shfrytëzueshme komplet rruga. Problemi tjetër është me rrugën e bjeshkës. Menjëherë mbi fshat vërshimet e fundit e kanë dëmtue aq shumë rrugën, sa që ato prona lart kanë mbet gati të pashfrytëzueshme, për shkak se, pak nëse bjer shi, gropat janë të mëdha, shesin makineria dhe nuk mund të kalohet lart për me i punue ato tokat. Edhe e fundit, besoj se jeni të gjithë në njohuri, fshati Shajne është bërë cak i hedhjes së mbeturinave. Konkretisht, pjesa e poshtme, te Zona Industriale ku janë edhe fabrikat, por tash më kanë kaluar edhe në pjesën prapa fabrikës andej, janë duke hedhë në të gjitha anët mbeturina. A keni njohuri për këtë, a ju ka njoftuar dikush dhe a keni paraparë diçka për mbledhjen e këtyre mbeturinave, sepse me të vërtet janë teprue, janë bërë shumë. Nuk ka një vend, tash qesin në të gjitha anët, edhe aso mbeturina që nuk asgjësohen. Ju faleminderit!

**Ardit Kalanderi, përfaqësues i fshatit Kosavë:** Përshëndetje për të gjithë! Prioritete apo kërkesat për vitet në vazhdim të komunitetit që përfaqësoj janë: së pari është ndërtimi i ndriçimit brenda fshatit, pasi që faza e parë ka përfunduar, nga Mejdani deri në hyrje të fshatit; Kërkesë e dytë është kubëzimi apo asfaltimi i rrugës Kosavë-Kuk, pasi që edhe këtu vetëm kanë filluar procedurat për

hapjen e saj; Kërkesë tjetër është rregullimi i rrugës për Bjeshkë, pasi është dëmtuar nga vërshimet; Një kërkesë tjetër është edhe ndërtimi i stadiumit brenda apo në hyrje të fshatit - janë dy opsione aty, afër Mejdanit apo te Shkolla – së bashku me një kënd të lojërave. Po ashtu, stadiumi të jetë me tepih artificial, si dhe me infrastrukturë përcjellëse, me rrethojë, ndriçim etj.; Kërkesë tjetër është edhe ndërtimi i disa mureve mbrojtëse përgjatë rrjedhës së lumit, sidomos në mahallat Besen dhe Mejzini; Si kërkesë e fundit është rregullimi i një pjese të kanalizimit e cila është dëmtuar sidomos nga vërshimet e fundit. Faleminderit!

**Zyber Krasniqi, përfaqësues i fshatit Brezne:** Përshëndetje për të gjithë! Fashti Brezne, njëri ndër fshatrat më të mëdhenj të Komunës së Dragashit, i harruar për 20 vite nga udhëheqësitë e kalume. Dua ta falënderoj kryetarin për punët edhe për iniciativat, duke u mundue me zgjidhë shumë probleme në fshatin tonë, probleme këto të cilat janë jetike. Kemi pas dhe kemi problem me kanalizimin dhe ujin e pijshëm, me rrugët, këto probleme të cilat kanë ndikue në shpërnguljen e banorëve. Përkundër punimeve që janë bërë me ndriçim, ne kemi prapë defekte të shumta me ndriçim. Projekti është i përfunduar, mirëpo drita nuk mund të dhezen për shkak të kyçjes me rrymë. Kemi kanalizimin. Qeverisja e tanishme e ka marrë iniciativën që e përshëndes, mirëpo hala nuk ka përfundue si projekt, që ka ndikue edhe në prishjen e rrugëve dhe ka ngrit shqetësime të tjera tek banorët. Kërkoj nga qeverisja aktuale të na japë sqarim shtesë, që ne të informojmë banorët e fshatit Brezne. Ngaqë jemi fshat shumë i madh, vuajmë nga mungesa e ujit të pijes, që është elementi kryesor për jetë. Meqenëse folët për bujqësi dhe turizëm, Breznja është një fshat i madh dhe ka një reliev bukur të mirë, për fat e kemi edhe Liqenin që është krenari dhe aset i Komunës. Dua me e ditë se a ka diçka më konkrete për të zhvillue turizmin përmes Liqenit? Ne si banorë, në bashkëpunim me kryetarin e Komunës kemi arrit që ta hapim pikën ndërkombëtare të Take OFF-it, në Brezne. Rruga është e hapur, por jo funksionale për të shku atje. Kemi edhe një problem jashtëzakonisht të madh për mbeturinat që janë te Trokani. Nga një natyrë shumë e bukur, është bërë një ferr që kundërmon erë të keqe. A ka pas me u mbyllë, a duhet të mbyllet, apo ai kaos që është krijue aty a është në rregull për banorët të cilët jetojnë dhe për Komunën tonë, fatkeqësisht. Kërkojmë prapë nga Komuna, përkundër që janë angazhuar shumë dhe ka hap edhe rrugë alternative, gjatë stinës së dimrit të bëjë pastrimin edhe më mirë të rrugëve alternative, ngase gjatë muajit dhjetor po vijnë edhe mërgimtarët dhe fshati po bllokohet tërësisht. Kisha kërkuar sqarim më të detajuar për shtrimin e rrugëve, kubëzimin apo asfaltimin e rrugëve të mbetura, edhe brenda fshatit, por edhe rrugës së Shullonit, edhe rrugës që çon prej te “Gurëza” te Take OFF-i. Faleminderit!

**Brendi Berisha, përfaqësues i fshatit Buqe:** Përsëritet për të gjithë! Po e shfrytëzoj rastin me i përmend disa kërkesa që i kemi për fshatin Buqe: Ne më herët e kemi pas një projekt që e kemi pas si kërkesë përmes KFOR-it Turk. Kemi kërkuar me e hap rrugën nga fshati për në bjeshkë. Kryetari është mundue, bashkë me mu kemi qenë disa herë kemi bërë kërkesë te KFOR-i Turk, por u ndërruan ato njësitë që patën me na ndihmë dhe rruga sot e atëherë nuk është e hapur ose e rehabilituar. Ju kujtoj se kjo rrugë, pra rruga që çon nga fshati Buqe, që quhet “Kodra e Pyllit”, përdoret edhe nga fshatrat Rapçë, Plavë dhe Buqe, për eksplorim të natyrës, është rruga për me u kyç në bjeshkët e Koritnikut. Prandaj edhe një herë po kërkoj, le të jetë si prioritet për vitet e ardhshme, që me u hap kjo rrugë, me u shtruar edhe me asfalt, pse jo. Pastaj, si prioritet tjetër, që me gjasë është kërkuar edhe përmes Asamblesë Komunale, ndriçimi i rrugëve të fshatit. Shpresoj që do të ndodhë në pjesën e parë të vitit. Tjetra, shpresoj se do të hartohet një projekt nga Komuna, gjegjësisht Drejtoria e Urbanizmit, për rehabilitim të disa rrugëve të cilat janë dëmtuar. Njëra pjesë është pjesa nga fshati që lidhet Buqja me Breznen. Për shkak të kamionëve me ngarkesë të cilët kanë kaluar, aty është shkaktuar njëfarë dëmtimi i disa pjesëve; rruga të shkolla. Dhe së fundmi, si kërkesë e banorëve është rruga unazore tek varrezat, të lidhet me asfalt me pjesën kryesore të fshatit. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Unë do të përpiqem të jap përgjigje të shkurta për të gjitha ata të cilët diskutuan. Fillimisht duhet të ju them se kërkesat e qytetarëve do të merren parasysh. Por, ndarja e buxhetit së pari ka me u bërë në bazë të rëndësisë së projektit; e dyta, në bazë të numrit të banorëve të fshatit; edhe e treta, një herë do të orientohemi në investimet që janë brenda në fshat. Kur t'i kryejmë investimet brenda në fshat, atëherë dalim jashtë fshatit. Për shembull, në Buqe ishte kërkesa e rrugës, por unë mendoj se prioritet është ndriçimi. Sa i përket pyetjes së Kamber Kamberit, për ujin ne planifikojmë që kah shtatori të përfundojë projekti i ujësjellësit. Unë e di që uji deri në Rapçë ka mbërri, ka mbetur vetëm edhe një pjesë e vogël për me shkue deri te Kërsteci. Sa i përket Rapçës, janë disa punë shumë të vogla, do ta kesh mbështetjen time. Ti je edhe punëtor i Komunës, shkojsh te Urbanizmi, shiko, nëse nuk është projekti, atëherë bëre një kërkesë, bëre një paramasë e parallogari, mund ta kryejmë atë punë edhe me Mallra dhe Shërbime. Për mirëmbajtjen verore, e kemi ne tenderin. Me mirëmbajtjen e ndriçimit publik, jo vetëm te ju, por në të gjitha fshatrat e kemi problem. Është një kompani e cila, përveç që e ka marrë mirëmbajtjen, po merr edhe tendera për instalime të reja, edhe tash ajo nuk po mund të mbërrij, po i lë punët zhag. Edhe për mu është dëm dhe keq. Unë sot kam pas një takim me mbikëqyrësin Florim Krasniqi, sot ai e ka thirrë në bisedë këtë kompaninë. Sehati pyeti për Dragashin e poshtëm sa i

përket kubëzimet që i përmende, janë kubëzime të vogla, besoj që ato do t'i kryejmë. Murin mbrojtës e kemi projekt, kemi ndarë mjaft mjete dhe besoj që ka me fillue sivjet, i kemi dy tenderë, njëri prej tyre presim me u hap këto dy ditët. Besoj që vlera e mjeteve që do të ndahen për ndërtimin e murit mbrojtës përgjatë rrugës që shkon për stadion, ndoshta do të jetë gati 100 mijë euro. Për rrugën që me e shti lumin në gypa prej Stacionit të Veterinës, nuk e di a lejohet kjo punë. Por ne së shpejti do ta shpallim edhe tenderin për Planin Zhvillimor Komunal, edhe aty do të ketë debat me qytetarët ku mund t'i parashtroni edhe kërkesat e juaja në këtë debat. Ylli i bëni disa kërkesa për fshatin Bellobrad, këto kërkesa për mu kanë qenë të njoftuna. Janë kërkesa që mund të realizohen. Përveç kësaj kërkesës që me e mbulue stadionin që nuk e kam ditë, tash ka ardhë si kërkesë e re. Beqir Beqaj, për me formue drejtori të posaçme për bujqësi dhe turizëm. Drejtoria për Bujqësi ekziston, por për turizëm është në kuadër të Drejtorisë për Bujqësisë. Është mirë me e formue një drejtori të turizmit, por për me e bo këtë duhet me u ndryshue Statuti i Komunës, i cili nuk mund të ndryshohet pa 2/3 e votave, duhet me bo marrëveshje me partitë politike. Sa i përket neve që jemi në pozitë, ne jemi pro, sepse Statuti ka qe 15 vjet që nuk është ndryshuar. Por duhet të ketë vullnet politik të partive politike, sepse duhet të sigurohen votat e Asamblesë Komunale. Për rrugën e Mejdanit, është një kërkesë e arsyeshme, mirëpo për këtë duhet me pas mjete, nëse arrijmë me sigurue mjete edhe këtë rrugën do ta rregullojmë. Nesim Qafleshi foli për zhvillimin e turizmit. Ju e dini që pengesë kryesore e zhvillimit të turizmit të Komunës sonë janë Parku Nacional dhe toka që është nën menaxhim të AKP-së. Për Parkun Nacional, ministria e ka marrë një aksion, është duke u bërë një debat publik dhe sigurisht do të ketë lehtësira. Ne i kemi paraqit kërkesat tona me shkrim, presim që këto të fillojnë të realizohen nga viti i ardhshëm. Sa i përket pyetjes së Nazim Dautit për zgjerimin e deponisë ekzistuese, është në programin tonë që duhet të zgjerohet. Sa i përket pyetjeve të Gazmend Ramadanit, kërkesa për te Kodra e Liqenit është kërkesë edhe e mëhershme. Edhe te rruga e Buzezit është duke u punuar, urën e kemi bërë në vitin e parë të qeverisjes. Për murin mbrojtës te shkolla, do ta realizojmë, nuk është problem. Bekim Vehapi bëri pyetje se a janë duke u realizuar projektet. Po, ka shumë projekte të cilat pritet të realizohen. Tenderi është mbyllë, ka konkurrue një kompani, brenda buxhetit, janë në pyetje diku 156 mijë euro, ku do të kubëzohen të gjitha rrugët brenda fshatit Shajne dhe do të kryhet një pjesë e një ujësjellësi, dhe një pjesë e ndriçimit publik që ka mbetur pa u krye. Sa i përket Rrugës Unazore, ne kemi paraparë që me Grantin e Performancës të investohet në këtë drejtim, tenderi është i shpallur, brenda javës hapen ofertat dhe shohim firmat që kanë konkurrue. Kemi probleme me kompanitë, sepse po kemi shumë pak kompani vendore, po konkurrojnë kompani të huaja, tash

pikën që nuk kemi mendue që vështirë ka qenë i realizueshëm, po ekzekutohet shumë me sukses. Do të jeni dëshmitarë që para shtatorit do ta bëjmë edhe lëshimin e këtij ujësjellësi. Sa i përket mbeturinave, që prej fillimit jemi duke bërë përpjekje që, edhe mundësisht me e gjet një vend për deponi të re, por i kemi caktuar edhe dy vende për mbeturina të ngurta. Një pjesë është kah Rrenci dhe një është kah Orqusha. Sa i përket problemit në Shajne, ne kemi intervenuar deri tash tri herë, është duke na kushtuar që në mënyrë ilegale po shkojnë po na i gjuajnë mbeturinat. Ne kemi bërë çmos për me e mbajtur këtë ambientin, kemi dhënë edhe para shtesë dhe jemi të interesuar me mbajtur shtesë. Por, këto unë besoj që bashkërisht ne si qytetarë, si qeveri bashkë me qytetarët mundemi me e bo një zgjidhje, me propozue, me dhënë mendime, dhe ne besoj që jemi të gatshëm. Nuk është çështja e parave, më shumë është çështja e vendit dhe procedurave. Me këto dy projekte kemi konkurruar në fondet e BE-së, që t'i bëjmë dy deponi të ngurta me standarde, që mos të kemi problem për një kohë të shkurtë, por të jenë afatgjatë. Besojmë se kërkesat tuaja nuk janë të kushtueshme dhe shumicën e investimeve të mëdha jemi duke i përfunduar, dhe do të kemi para të mjaftueshme për t'i adresuar të gjitha këto kërkesa.

**Bexhet Xheladini:** Ju falënderoj edhe një herë për pjesëmarrje në këtë debat! Shihemi në takimet e radhës!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://dragash.rks.gov.net/news/komuna-e-dragashit-jilloi-degjimet-buxhetore-me-qytetare-per-kab-2026-2028/>

Boshnjakisht:

**Në Facebook:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/15jqdoJ6Xu/>

Boshnjakisht:

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E DRAGASHIT  
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 10.06.2025

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME  
KRYETARË TË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, OJQ, BIZNESE DHE  
FERMERË PËR KAB 2026-2028

LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA  
PREDSIEDNICIMA SEOSKIH SAVETA, NVO-IMA, PREDUZEĆIMA I  
POLJOPRIVREDNICIMA ZA SBO 2026-2028

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Vendbanimi   | Etnia<br>Etnička<br>pripadnost | M | F | Nënshkrimi |
|-----|------------------|--------------|--------------------------------|---|---|------------|
| Br. | Ime i Prezime    | Prebivalište |                                | M | Ž | Potpis     |
| 1   | Besart Mehmeti   | Kuk          | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 2   | RESUL FETAHU     | Kuk          | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 3   | Mazir Hamza      | Kristac      | Bošnjak                        | ✓ |   |            |
| 4   | Mazir Hamza      | Dragash      | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 5   | Mahadin Gerdolli | Rrençe       | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 6   | Ruslan Dauti     | Krasnie      | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 7   | Bekim Vekari     | Shqipe       | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 8   | Enall Bajrami    | Dragash      | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 9   | SEHAT IDRISI     | DRAGAŠ       | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 10  | ALI R. GASI      | PREZNE       | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 11  | ZYBER KUSHI      | PREZNE       | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 12  | Dreni Myrtetari  | ZAPLUXIN     | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 13  | Burim Aliu       | Blac         | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 14  | Burim Gafleshi   | Bellac       | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 15  | Bekir Selmani    | KUK          | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 16  | Lirin Karimani   | Blac         | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 17  | RESHAT ALIDA     | BLAC         | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 18  | Kamir Kamir      | PADEA        | Bošnjak                        | ✓ |   |            |
| 19  | Munir Jemal      | Lajca        | Kosovjak                       | ✓ |   |            |
| 20  | Munir Jemal      | PADEA        | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 21  | ARDIT KALANDEK   | KOŠTAC       | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 22  | Zemredina Hecani | Dragash      | Shqiptar                       |   | ✓ |            |
| 23  | Keton Heli       | Zaplathe     | Shqiptar                       | ✓ |   |            |
| 24  | LINDITA RIBAJ    | Dragash      | Shq.                           |   | ✓ |            |
| 25  | TLI GAFLESHI     | BELLAC       | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |
| 26  | SHAGIR SIKIRAJ   | KRASH        | SHQIPTAR                       | ✓ |   |            |

Komuna e Dragashit  
Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/01-10196/25

10.06. 2025  
Dragash - Dragaš

|    |                    |         |           |   |  |  |
|----|--------------------|---------|-----------|---|--|--|
| 27 | Fani Kollam        | Konawe  | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 28 | Fatoni Halimani    | Konawe  | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 29 | NEGIRI BAKU        | BELLOBO | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 30 | Bismillah & Sonora | BELLOBO | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 31 | Zeni Pranggi       | Buge    | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 32 | Bekir Beka         | Konawe  | Sejahtera | ✓ |  |  |
| 33 | BEGIR BEKA         | BELLOBO | (AL)      | ✓ |  |  |
| 34 |                    |         |           |   |  |  |
| 35 |                    |         |           |   |  |  |
| 36 |                    |         |           |   |  |  |
| 37 |                    |         |           |   |  |  |
| 38 |                    |         |           |   |  |  |
| 39 |                    |         |           |   |  |  |
| 40 |                    |         |           |   |  |  |
| 41 |                    |         |           |   |  |  |
| 42 |                    |         |           |   |  |  |
| 43 |                    |         |           |   |  |  |
| 44 |                    |         |           |   |  |  |
| 45 |                    |         |           |   |  |  |
| 46 |                    |         |           |   |  |  |
| 47 |                    |         |           |   |  |  |
| 48 |                    |         |           |   |  |  |
| 49 |                    |         |           |   |  |  |
| 50 |                    |         |           |   |  |  |
| 51 |                    |         |           |   |  |  |
| 52 |                    |         |           |   |  |  |
| 53 |                    |         |           |   |  |  |
| 54 |                    |         |           |   |  |  |
| 55 |                    |         |           |   |  |  |
| 56 |                    |         |           |   |  |  |
| 57 |                    |         |           |   |  |  |
| 58 |                    |         |           |   |  |  |
| 59 |                    |         |           |   |  |  |
| 60 |                    |         |           |   |  |  |
| 61 |                    |         |           |   |  |  |
| 62 |                    |         |           |   |  |  |
| 63 |                    |         |           |   |  |  |
| 64 |                    |         |           |   |  |  |
| 65 |                    |         |           |   |  |  |
| 66 |                    |         |           |   |  |  |
| 67 |                    |         |           |   |  |  |
| 68 |                    |         |           |   |  |  |
| 69 |                    |         |           |   |  |  |
| 70 |                    |         |           |   |  |  |



